



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 907 prot.

Tiranë, më 03 . 08 . 2023

V E N D I M

Nr. 154 , datë 03 . 08 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 19 Regj., datë 24.01.2023, të paraqitur nga subjekti ankues, I. D, kundër Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “vendbanimit³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, I. D, rezulton se me datë 13.12.2022, ai i ka drejtuar një kërkesë Departamentit të Marketing-Turizmit, pranë Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës, për ndjekjen e programit të studimit të doktoraturës.

Nëpërmjet email-it të dërguar nga Kryetarja e Degës së Kualifikimit Shkencor pranë këtij Fakulteti (FE/UT), ankuesit i është bërë me dije se dosja e tij e aplikimit për doktoraturë pranë FE/UT nuk mund të konsiderohet pasi vendqëndrimi i tij është jashtë Shqipërisë (referuar vërtetimit të punësimit pranë American University Middle East⁴).

Ky qëndrim është evidentuar edhe në email-et vijuese mes ankuesit dhe Kryetares së Degës së Kualifikimit Shkencor, FE/UT, duke cituar, ndër të tjera, si mëposhtë:

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Vendbanimit për shkak të punësimit jashtë Shqipërisë, në shtetin e Kuvajtit.

⁴ Në vijim referuar edhe me akronimin AUM.

“Ju bëjmë me dije se kuotat e doktoraturave të ofruara nga FE/UT janë për personelin akademik apo personelin kërkimor shkencor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar pranë IAL-ve në Shqipëri apo të IAL-ve që kanë marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës.

Në këto kushte, ju sugjerojmë të ndërhyni tek eprori i universitetit ku punoni për të realizuar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës”.

Nga komunikimi me email mes tyre, evidentohet se ankuesi ka kërkuar sqarime lidhur me faktin se mbi bazën e cilit akt ligjor apo nënligjor bazohet argumentimi i FE/UT, ku të jetë përcaktuar si kriter përjashtues fakti që personat me punësim jashtë vendit nuk mund të aplikojnë në studimet e ciklit të tretë në Shqipëri. Përgjigjja që i është komunikuar nga Fakulteti është se: *“Kuotat e doktoraturave ofruar nga FE/UE, janë për personelin akademik apo personelin kërkimor shkencor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar pranë IAL-ve në Shqipëri apo IAL-ve që kanë marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës”.*

Lidhur me argumentimin e mësipërm të FE/UT, ankuesi pretendon se është shtrembërim i interpretimit të ligjit nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë”*, pasi pikës 2, të nenit 79, të tij, i janë shtuar fjalë e fraza për të përligjur vendimin që dosja e aplikimit të tij për doktoraturë të përjashtohet e të mos dërgohej pranë Komisionit të Departamentit ku ai kishte aplikuar. Ai thekson faktin që, kjo është hera e dytë që ka aplikuar në programin e doktoraturës, dhe se herën e parë dosja e tij është shqyrtuar nga Departamenti i Menaxhimit dhe ngre dyshimin se Kryetarja e Degës së Kualifikimit Shkencor, FE/UT është në tejkalim të kompetencës së saj.

Ankuesi shprehet se është i punësuar si personel kërkimor me kohë të plotë pranë shoqatës Unique Junior Enterprise, me operim në Tiranë/Shqipëri, në zbatim të projekteve në fushën e sipërmarrjes. Shoqatë kjo, e cila është e certifikuar si *“Lehtësues”* për ofrimin e shërbimeve të konsulencës dhe të kërkimit shkencor për biznese të reja (startup) nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Ankuesi shprehet se punësimi i tij jashtë Shqipërisë, edhe pse i përkohshëm me kohë të pjesshme e dytësor, duhet të ishte një vlerë e shtuar dhe jo një kriter përjashtues e diskriminues, për më tepër kur në asnjë nga kriteret e shpallura nga Fakulteti, nuk cilësohej se vendbanimi (apo vendqendrimi) duhet të ishte në Shqipëri detyrimisht.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masa për ndalimin e sjelljes diskriminuese kundrejt tij, dhe ndreqjen e situates, duke detyruar FE/UT të marrë në konsideratë aplikimin e tij dhe ta dorëzojë atë në Komisionet përkatëse të ngritura për vlerësimin e aplikimeve pranë Departamentit përkatës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin*

gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim nga ana e Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 148/1 prot., datë 03.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime FEUT, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Në vijim, nëpërmjet shkresave me nr. 184/1 prot, datë 07.02.2023⁵, dhe me nr. 337/5 prot., datë 13.02.2023, FEUT, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke parashtruar ndër të tjera se:

“Procedura me gjithë dokumentacionin ligjor përkatës në lidhje me aplikimet dhe pranimet në studimet e doktoraturës pranë FEUT, janë bërë publike dhe të aksesueshme, për të gjithë të interesuarit për këtë process dhe gjenden aktualisht në faqen zyrtare të FEUT....

I. D ka aplikuar në muajin prill 2022 pranë Departamentit të Menaxhimit dhe nga Komisioni përkatës kandidatura e tij nuk u trajtua në grupin e kandidatëve konkurues, në aspekt dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Aplikanti është i punësuar me kohë të plotë pranë AUM Kuvajt, me të cilin Universiteti i Tiranës nuk ka marrëveshje bashkëpunimi për asnjë aspekt që parashikohet në funksionimin e arsimit të lartë. Pranë këtij Universiteti janë punësuar një grup ish-pedagogësh dhe ish-studentësh të UT, por procedura e punësimit të tyre ka qenë individuale.

⁵ Referuar tek shkresa me nr. 153/1 prot., datë 06.02.2023 e FEUT-së.

Në zbatim të kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë për programin e doktoraturave, FEUT ka pasur detyrimin që të trajtojë dhe të përzgjedhë aplikantë që janë personel akademik pranë UT dhe IAL-ve publike dhe jopublike në Shqipëri dhe Kosovë dhe për aplikantë të punësuar në institucione të ndryshme në Shqipëri, që kanë lidhje me kërkimin shkencor dhe plotësojnë kriteret e shpallura nga FEUT.

Në aplikimet e muajit prill ka pasur edhe një aplikante tjetër, të punësuar në universitetin ku punon z. D, e cila aplikoi pranë Departamentit të Financës dhe që nuk u trajtua nga Komisioni përkatës në grupin e kandidatëve konkurrues.

Për sa më sipër, z. D e ka pritur dhe sqaruar Dekani i FE dhe është larguar i qartë nga takimi.

Ju informojmë se, kemi pasur edhe raste të tjera të aplikantëve të punësuar dhe më banim jashtë Shqipërisë, të cilët nuk janë trajtuar nga komisionet përkatëse pranë departamenteve të FE. Ndryshe nga të gjithë apkinatët e tjerë në kushte të njëjta, z. D ka riaplikuar pranë një departamenti tjetër dhe në thirrjen e FEUT për programin e doktoraturës për vitin akademik 2022-2023.

Natyrshtëm që aplikimi i tij nuk u mor në konsideratë, pasi ishte në të njëjta kushte sikurse në aplikimin e muajit prill 2022”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 148/4 prot., datë 05.04.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, në datën 27.04.2023, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit.
3. Nëpërmjet emailit të datës 25.04.2023, ankuesi ka njoftuar për pamundësinë e tij për të marrë pjesë në seancë me datë 27.04.2023, dhe se data e parë e mundshme për të ishte me datë 24.06.2023.

Pas shqyrtimit të sa më sipër, Komisioneri vlerësoi të paarsyeshme kërkesën e ankuesit për shtyrjen e seancës për një periudhë kohore 2 mujore. Në këto kushte, Komisioneri vendosi që seanca të zhvillohej vetëm me pjesëmarrjen e FEUT, dhe në vijim ankuesi do të njëjhej me parashtimet dhe materialet e seancës së zhvilluar.

4. Subjekti ankues është njoftuar për sa më lart, nga inspektori i çështjes, nëpërmjet emailit të datës 26.04.2023.
5. Seanca u zhvillua në datë 27.04.2022, në mungesë të subjektit ankues dhe me praninë e përfaqësuesve me autorizim të FEUT-së dhe Rektoratit të UT-së. Kështu:
 - Me Autorizimin me nr. 337/8 prot., datë 26.04.2023, Rektori i UT-së, përfaqësohej në seancë nga G. T, me detyrë Përgjegjës në Sektorin Juridik, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme.

- Me Autorizimin me nr. 206/6 prot., datë 26.04.2023, FEUT, përfaqësohej në seancë nga M. K, me detyrë Zëvendës Dekane e FEUT, dhe A. B, me detyrë Kryetare e Degës së Kualifikimit Shkencor në FEUT.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e FEUT-së dhe UT-së, paraqitën parashtrimet⁶ si më poshtë citojmë:

“Së pari, nuk provohet që skualifikimi i aplikimit të ankuesit ka ndodhur për shkak të diskriminimit për shkak të “vendbanimit”.

Duke mos pasur asnjë alibi rreth shkakut fillestar të diskriminimit, mbi bazë të “vendbanimit”. Tiranë, sipas akteve të gjendjes civile, ankuesi ka ndryshuar shkakun e diskriminimit, duke pretenduar se diskriminimi ka ndodhur për shkak të punësimit jashtë vendit në momentin e aplikimit.

Meqenëse, diskriminimi për shkak të punësimit, nuk është i parashikuar në asnjë nga format e tij të përcaktuara në mënyrë të qartë në pikën 2 të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 1, të ligjit nr. 10221 , datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, atëherë referuar nenit 33, pika 4/c të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2023, ankesa nr. 19. Regj, datë 24.01.2023, duhet të mos pranohet, bazuar në shkakun e ri të diskriminimit, mbi baza të punësimit, pasi ankesa mbi këtë shkak është e është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010.

Së dyti, në parashtrimet dhe objeksionet e ankuesit është pranuar se, “... Dorëzimi i aplikimit tim të dytë është bërë nga një person i tretë...”

Në lidhje me këtë pohim, ritheksojmë se, ankuesi ka pohuar pretendimet e paraqitura në seancë dëgjimore nga Universiteti i Tiranës se, ai nuk ka aplikuar personalisht dhe se, nënshkrimi i aplikimit datë 15.12.2022 si dhe i deklaratës antiplagjaturë është kryer nga një person tjetër në emër të aplikantit I. D.

Aplikimi nëpërmjet një personi të tretë dhe jo në mënyrë individuale, për regjistrimin në programin e "Doktoratës" është në kundërshtim me pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1 12, datë 23.02.2018 "Përpërcaktimin e kriterëve për përfitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar " dhe "Profesor " që ka parashikuar se:

“...4. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Njësia bazë miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato fusha, të cilat u përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron....”.

⁶ Depozituar edhe shkresërisht.

Argumentimi, i ankuesit se, personat e ngarkuar për pranimin e aplikimeve nuk kanë kundërshtuar aplikimin e ankuesit nga persona të tretë, nuk do të thotë që vlefshmëria e aplikimit nuk mund të verifikohet më pas, për më tepër që ka një parashikim me akt nënligjor që rregullon mënyrën e aplikimit. Sa më sipër, do të mjaftonte vetëm konstatimi i faktit se, aplikimi i ankuesit për programin e studimit është realizuar në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 112, datë 23.02.2018, që ai të skualifikohet nga procedura për regjistrimin në programin e doktoratës, për vitin akademik 2022-2023.

Së treti, ankuesi ka pretenduar në objeksionet/parashtrimet e tij se:

“...Kësisoj nuk e kam të qartë se si ndryshe nga çdo univeristet në botë, pranë UT janë të detyruar të pranojnë aplikime vetëm nga punonjës brenda Shqipërisë. Sic edhe më është deklaruar nëpërmjet e-mailit si arsye refuzimi, fakti se doktorantët duhet të punojnë në Shqipëri është një shtesë e qëllimtë që përfaqësuesit i bëjnë Ligjit...”.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit në objeksionet e tij, ritheksojmë edhe një herë se, në pikën 2 dhe 3 të nenit 79 të ligjit nr. 80/2015, parashikohet se:

“...2. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese....”.

Ndërsa në pikën 1.5 të “Rregullores për organizimin e programit të studimit të doktoratës në Fakultetin e Ekonomisë, të UT-së”, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 21.07.2021, të Dekanatit, është parashikuar se: “...Studimet e doktoratës ofrohen me prioritet për ata persona që e kanë detyrim ligjor kualifikimin e tyre në nivelin e tretë të studimeve, për shkak të punësimit si personel akademik në IAL...”.

Pra, pretendimi i ankuesit I. D, se, fakti se doktorantët duhet të punojnë në Shqipëri është një shtesë e qëllimtë që përfaqësuesit i bëjnë Ligjit, nuk është një sajesë, por një kusht i parashikuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 79, të ligjit nr. 80/2015.

Ankuesi/aplikanti I. D nuk plotëson asnjërin nga kriteret e parashikuara në dispozitat ligjore dhe rregulloren e programit të studimit të doktoratës, të Fakultetit të Ekonomisë, të sipërcituara, si rrjedhim në përputhje me parimin e ligjshmërisë, strukturat përgjegjëse të departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë, kanë skualifikuar aplikimin e ankuesit, edhe për këtë shkak.

Në vijim të argumenteve të tij, ankuesi ka pretenduar se:

“..unë rezultoj i punësuar në Shqipëri pranë shoqatës Unique Junior Enterprise duke ndërmarrë dhe projekte me zhvillim në territorin e Shqipërisë, më i fundit përgjatë muajve Gusht - Dhjetor 2022. Këtë vërtetim e kam paraqitur në dosjen e aplikimit, por përfaësuesit e UT, kanë parë të arsyeshme vetëm vërtetimin e punës time në Kuvajt, një punë e cila nuk më ka penguar deri më sot të zhvilloj projekte kërkimore në Shqipëri....”.

Në lidhje me këtë pretendim, ju bëjmë me dije se, në pikën 7 të nenit 79 të ligjit nr. 80/2015, parashikohet se:

“...7. Këshilli i Ministrave miraton kriteret që duhet të përmbushë kandidati për fitimin e gradës shkencore "Doktor", sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe standardet për fitimin e titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar”.

Në pikën 1, të VKM nr. 112, datë 23.2.2018, e ndryshuar parashikohet se:

“...1. Studimet për gradën shkencore "Doktor" zhvillohen me kohe të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit "universitet" ose "akademi", të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim....”.

Punësimi i ankuesit I. D në një shoqatë, pavarësisht objektit të veprimtarisë dhe pagës së tij minimale me të cilën paguhet në këtë shoqatë, të parashikuar me akt nënligjor, nuk plotëson kriterin e parashikuar në pikën 1, të aktit të sipërcituar, për shkak se, shoqata nuk mund të identifikohet me një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të llojit "universitet" ose "akademi”.

Sa më sipër, ankuesi/aplikanti, nuk plotëson asnjërin nga kriteret e parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 79 të ligjit nr. 80/2015, pikën 1, të VKM nr. 112, datë 23.2.2018 dhe pikën 1.5, të “Rregullores për organizimin e programit të studimit të doktoratës në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës”, prandaj skualifikimi i tij nuk bazohet në asnjërin nga rastet e diskriminimit, por për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të parashikuara në ligj, akt nënligjor dhe në rregulloren e fakultetit të miratuar në përputhje me këto akte.

I njëjti skualifikim është vendosur edhe për rastin e aplikantes E. D, e cila është e punësuar në një institucion të arsimit të lartë në të njëjtin shtet, ku është i punësuar ankuesi, por ajo nuk e ka trajtuar skualifikimin e saj mbi të njëjtin shkak si një nga rastet e diskriminimit, siç pretendon ankuesi.

Për sa i përket, pretendimit të ankuesit se: “...Fjalët “në Shqipëri dhe Kosovë” në lidhje me kriteret e aplikimit për programin e doktoraturës nuk gjenden në asnjë nen të Ligjit të Arsimit të Lartë, vendim e rregullore të Universitetit të Tiranës apo listë kriteresh për aplikim....”, ju bëjmë me dije se, në zbatim të VKM nr. 768, datë 02.11.2011 janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrive respektive përgjegjëse për arsimin, për ndjekjen e programeve respektive të studimit.

Deri më sot nuk na është komunikuar asnjë urdhër tjetër që shfuqizon apo ndryshon marrëveshjet mes dy shteteve, prandaj edhe në kriteret e aplikimit është shtuar togfjalëshi “në Shqipëri dhe Kosovë”.

Së katërti,.....në lidhje me pretendimin e fundit se, çfarë ndodh me një doktorant që largohet jashtë vendit, ju bëjmë me dije, se, në rastin e doktorantes I. B, e cila është larguar jashtë vendit, kjo procedurë është pezulluar.

Përfundimisht, skualifikimi i ankuesit nga procedura për ndjekjen e programit të doktoratës në Fakultetin e Ekonomisë është i përligjur dhe bazohet në kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, duke rrëzuar pretendimet e tij mbi shkaqet e diskriminimit”.

6. Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri nëpërmjet e-mailit të datës 28.04.2023, njohu subjektin ankues me parashtrimet e depozituara gjatë seancës nga ana e FEUT-së, si dhe me procesverbalin e mbajtur gjatë seancës.

Në vijim të sa më sipër, subjekti ankues, me datë 01.05.2023 ka dërguar objeksione shtesë, duke shpjeguar si më poshtë vijon:

“Përfaqësuesit e UT në shkresën e depozituar pranë jush, në faqen 2, nënvizojnë faktin se “FEUT ka pasur detyrimin që të trajtojë dhe përzgjedhë aplikantë që janë personel akademik pranë UT dhe IAL-ve publike dhe jo publike në Shqipëri dhe Kosovë dhe për aplikantë të punësuar në insitucione të ndryshme në Shqipëri”. Fjalet “në Shqipëri dhe Kosovë” në lidhje me kriteret e aplikimit për programin e doktoraturës nuk gjenden në asnjë nen të Ligjit të Arsimit të Lartë, vendim e rregullore të Universitetit të Tiranës apo listë kriteresh për aplikim. Kësisoj nuk e kam të qartë se si ndryshe nga çdo univeristet në botë, pranë UT janë të detyruar të pranojnë aplikime vetëm nga punonjës brenda Shqipërisë. Siç edhe më është deklaruar nëpërmjet email si arsye refuzimi, fakti se doktorantët duhet të punojnë në Shqipëri është një shtesë e qëllimtë që përfaqësuesit i bëjnë Ligjit. Per herë të parë, nëpërmjet kësaj shkrese u njoha me faktin se edhe Kosova bën pjesë në listën e vendeve të lejuara për të punuar e aplikuar për doktoraturë, gjë e cila nuk gjendet në asnjë kriter të shpallur.

Por pavarësisht faktit se aplikimi im është refuzuar për shkak të punësimit tim jashtë Shqipërisë në momentin e aplikimit, unë rezultoj i punësuar në Shqipëri pranë shoqatës UNIQUE Junior Enterprise duke ndërmarrë dhe projekte me zhvillim në territorin e Shqipërisë, më i fundit përgjatë muajve Gusht 2022 – Dhjetor 2022. Këtë vërtetim e kam paraqitur në dosjen e aplikimit, por përfaqësuesit e UT kanë parë të arsyeshme vetëm vërtetimin e punës time në Kuvajt, një punë e cila nuk me ka penguar deri më sot të zhvillojë projekte kërkimore në Shqipëri. E nënvizoj faktin se unë jam refuzuar në momentin e shqyrtimit të aplikimeve, pa u dërguar dosja ime në departamentin përkatës. Ky refuzim është bërë nga nëpunësja e doktoraturës në mungesë

kompetence, pasi dosja duhet drejtuar pranë departamentit ku unë kam aplikuar. Kjo është një shkelje për të cilën nuk është dhënë asnjë sqarim.

Gjithashtu, nëse në rregulloren e doktoraturës shprehet se nuk lejohet të aplikojnë persona që jetojnë apo punojnë jashtë Shqipërisë e Kosovës, i ftoj përfaqësuesit të më vënë në dijeni me të tillë rregullash të miratuara. Ndjekja e doktoraturës është një proces i ndarë nga e drejta për të aplikuar. Ku e kam cituar unë që po aplikoj për të ndjekur doktoraturën online? Nga e dinë përfaqësuesit e UT se unë nuk do të kisha mundësi të isha prezent në takimet e departamentit? Nga e dinë përfaqësuesit e UT, se unë nuk do të isha në gjendje të përmbushja detyrimet e prezencës për çdo takim të planifikuar apo jo? Nga e dinë përfaqësuesit e UT që me pranimin në programin e doktoraturës, unë nuk do të kthehesha me qëndrim të përhershëm në Shqipëri? Po sikur një nga personat e shpallur fitues nga UT, largohet jashtë vendit apo nuk punon më në një institucion kërkimor, a mos vallë do ta përjashtonin nga shkolla e doktoraturës?

Siç ndodh kudo ne botë, një student aplikon në një universitet e nëse shpallet fitues do detyrohet të zbatojë rregulloren e institucionit, përfshirë këtu edhe ndjekjen fizike të klasave apo marrjen e lejes së vend-qendrimit. Ky është aburditeti i vërtetë në këtë çështje ku unë privohem nga e drejta e arsimimit pasi kam deklaruar se punoj në një institucion arsimor jashtë vendit, kur në fakt kjo duhet të ishte një vlerë e shtuar. Duke parë listën e fituesve do të shihni se ka dhjetëra aplikantë të cilët nuk kanë punuar, as nuk punojnë në institucione të arsimit të lartë apo të kërkimit bazë.

Në lidhje me argumentimet ligjore se Univeristet i Tiranës nuk është një organ shtetëror shqiptar, besoj se përderisa kërkesa ime është pranuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është e qartë se po flasim për një institucion të arsimit të lartë publik i cili me ligj ka 3 përfaqësues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit në Bordin e Administrimit e që vazhdon të financohet nga Qeveria e Shqipërisë.

Në lidhje me argumentimin e tretë ligjor të paraqitur, përfaqësuesit e UT theksojnë se unë nuk plotësoj asnjë nga kriteret e parashikuara. Konkretisht unë jam i punësuar në Shqipëri pranë një institucioni të kërkimit bazë ose të zbatuar, vertetimin e të cilit e kam vendosur në dokumentat e aplikimit, ku shprehimisht kam deklaruar se jam president i shoqatës UNIQUE Junior Enterprise e njohur nga Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si Facilitator, certifikatë që lëshohet për inkubatorët e startupeve ku nën drejtimin tim janë ndërmarrë disa projekte me bazë kërkimore. Për këtë po ju vë në dispozicion vërtetimin e vendimeve që përcaktojnë pozicionin tim në shoqatë, vërtetim për pagimin e kontributeve, si edhe certifikatën e lëshuar nga Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Kësisoj, unë e kam përmbushur kriterin e nenit 79 të ligjit nr.80/2015, pika 6.1.a.

Vlen të theksohet se në të dy rastet dokumentat e paraqitura në dosjen time të aplikimit janë shqyrtuar dhe konfirmuar në momentin e dorëzimit nga nënpunësi përkatës. Dorëzimi i aplikimit tim të dytë është bërë nga një person i tretë, me të gjitha dokumentat e nevojshme të firmosura nga unë. Nëpunësi përkatës është vënë në dijeni se dorëzimi është bërë nga një person i tretë (sic mund të ishte edhe nëpërmjet postës), dhe nuk e ka kundërshtuar aplikimin, por e ka pranuar dosjen dhe

e ka ftuar dorëzuesin të firmosë për dorëzimin e dokumentave. Nëse kjo përbën shkelje të ligjit, atëherë do u këshilloja përfaqësuesve të UT të rishikojnë procedurat e tyre të pranimit të aplikimeve.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një privim të së drejtës për arsimim në një institucion publik në Shqipëri, ku unë jam diskriminuar për shkak të punësimit jashtë vendit në momentin e aplikimit, vazhdoj të kërkoj nga Zyra për Mbrojtjen nga Diskriminimi të drejtën time që dosja ime e aplikimit të merret në shqyrtim nga departamenti përkatës dhe në rast se unë shpallëm fitues do të përmbush të gjitha detyrimet e lindura si dhe zbatimin e rregullores së programit të doktoraturës”.

- Në kuadër të parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pas seancës dëgjimore pranë KMD-së, nga palët, Komisioneri evidenton faktin se ato janë analizuar e vlerësuar gjatë vendimmarrjes së KMD-së, në harmoni me pretendimet dhe faktet e provat e tjera.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me aplikantë të tjerë të programit të studimeve të doktoratës, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Komisioneri evidenton faktin se, krahasimi i përdorur nga FEUT, duke u shprehur se të njëjtin trajtim ka bërë edhe për një kandidate tjetër, nuk qëndron dhe është i pambështetur pasi nuk është depozituar asnjë akt shkresor apo praktikë e ndjekur përse është cituar prej tyre, për të konkluduar nëse ndodhemi në të njëjta kushte e rrethana me ankuesin (me gjithë kërkesën e bërë nga Komisioneri⁷).

Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, Komisioneri vlerëson nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me aktet ligjore rregullatore.

Komisioneri vëren se, për vlerësimin e pretendimeve të subjektit ankues, gjatë analizës në këtë vendim, ka patur në konsideratë momentin e aplikimit të tij, dokumentacionin e depozituar lidhur me të, si dhe faktet e rrethanat që lidhen me këtë moment, që daton me 13.12.2022.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

⁷ Shkresa me nr. 148/4 prot., datë 05.04.2023 e KMD-së.

Me datë 25.11.2022, Departamenti i Marketing-Turizmit, pranë Fakultetit të Ekonomisë/UT, ka shpallur në faqen zyrtare të FEUT-së⁸, thirrjen e FEUT-së për aplikim për regjistrim në Programin e Doktoratës për vitin akademik 2022-2023.

Në faqen e FEUT-së, lidhur me aplikimin në këtë program, janë shpallur edhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në të. Kështu, në faqe është publikuar si më poshtë citohet: Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e Doktoratës në Shkenca Ekonomike në Fakultetin e Ekonomisë, UT:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta në Ekonomi, në të paktën njërin nga nivelet e mëparshme të studimeve;
- b) Të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit 4-vjeçar, apo nga një program studimi të barazvlefshëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
- c) Të ketë rezultate të larta në secilin nga studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
- d) Të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin nr. 52, datë 03.05.2015, të ndryshuar;
- e) Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij, apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe të vetëdeklarojë së është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike në programin e studimeve.

Në faqe është publikuar rubrika: Kush mund të aplikojnë Programin e Doktoratës pranë Fakultetit të Ekonomisë, me prioritete të shpallura, si më poshtë citohet:

Personel akademik i punësuar me kohë të plotë në:

- a) Fakultetin e Ekonomisë, UT;
- b) Fakultetin e Ekonomisë të universiteteve të tjera publike dhe jopublike.
- c) Staf akademik me kohë të pjesshme i FE/UT kur është i punësuar me kohë të plotë në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- d) Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike dhe jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të njëjësive bazë të Fakultetit të Ekonomisë.

Kriteret specifike të shpallura në faqe, janë si më poshtë citohen:

⁸ <https://feut.edu.al/lajmerime/1923-thirrje-per-aplikim-per-regjistrim-ne-programin-e-doktorates-per-vitin-akademik-2022-2023-prane-fakultetit-te-ekonomise-universiteti-i-tiranes>

- Të ketë përfunduar ciklin e parë (Bsc) në fushën e Financës ose të ngjashme me të, dhe ciklin e dytë (Msc), apo diplomë e integruar e nivelit të dytë, apo diplomë sipas sistemit 4-vjeçar, në fushën e Financës.
- Të zotërojë një titull tjetër studimi i fituar në Institucione të huaja të Arsimit të Lartë (pasi të jetë njohur nga institucionet shqiptare përkatëse), ciklin e parë (Bsc) në fushën e Financës ose të ngjashëm me të, dhe ciklin e dytë (Msc) në fushën e Financës.

.....
Nëqoftëse do aplikohet në programin e studimit Shkenca Ekonomike, nënfusha “Menaxhim” duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere:

- Të ketë përfunduar studimet për Menaxhim, ose në fusha të ngjashme me të, në të paktën në njërin prej cikleve të mëparshme të studimeve, Bsc ose Msc i Shkencave.

Në faqe është publikuar edhe informacioni se:

“Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkim shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.

Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Institucionet e arsimit të lartë vendosin kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor. Cikli i III-të i studimeve të doktoratës përfshihet në nivelin e 8-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese”.

Në vijim të kësaj shpallje, me shkresën me lëndë: “Kërkesë për ndjekjen e programit të studimit të doktoratës”, datë 13.12.2022, ankuesi i është drejtuar Departamentit të Marketing-Turizmit, pranë FEUT-së, me kërkesën për të ndjekur programin e studimit të doktoratës, pranë këtij Departamenti.

Nga këqyrja e akteve të dosjes së aplikimit të z. D, dorëzuar me datë 15.12.2022, në procesverbalin e mbajtur, rezulton të jenë depozituar aktet shkresore, specifikuar sipas rubrikave të procesverbalit, si më poshtë citohen:

- Kërkesë e kandidatit për nënfushën ku do të studiojë.
- Jetëshkrimi (CV).
- Kopje e noterizuar e diplomës bachelor dhe listës së notave.
- Kopje e noterizuar e diplomës master dhe listës së notave.
- Certifikatë personale.
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës.

- Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar.
- Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës.
- Vërtetim nga qendra e punës.
- Mandat pagese dhe vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e publikimit.

Ndërkaq, rezultojnë të paplotësuara rubrikat e këtij procesverbali (për rrjedhojë dhe dokumentacioni për sa kërkohet) si më poshtë citohet:

- Kopje e noterizuar e diplomës DIND.
- Vërtetim që kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë.
- Dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, programe shkëmbimi si Erasmus+, apo projekte kombëtare apo ndërkombëtare, certifikata për njohjen e programeve për përpunimin e të dhënave sasiore.

Nëpërmjet e-mailit të datës 19.12.2022, punonjësja A. B e FEUT, ka informuar kandidatin I. D, se dosja e tij e aplikimit nuk mund të konsiderohej, pasi vendqëndrimi i tij është jashtë Shqipërisë.

Në vijim të përgjigjes së FEUT-së, ankuesi ka kërkuar po me e-mail shpjegime lidhur me refuzimin e aplikimit të në programin e Doktoratës pranë Departamentit të Marketing-Turizmit.

Nga shkëmbimi i e-maileve të vazhdueshme mes ankuesit dhe punonjësës së FEUT-së⁹, evidentohet se, në mënyrë të përmbledhur, arsyet e shpjeguara nga ana e FEUT-së, janë sikurse citohet në emailin drejtuar z. D me datë 10.01.2023, si vijon:

“Ju bëjmë me dije se, kuotat e doktoraturave ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë/UT, janë për personelin akademik apo personelin kërkimor shkencor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë IAL-ve në Shqipëri apo IAL-ve që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UT. Në këto kushte, ju sugjerojmë të ndërhyni te eprori i universitetit ku ju punoni, për të realizuar një marrëveshje bashkëpunimi me UT.

Ju informojmë gjithashtu se, raste analoge ka patur edhe për kandidatë të tjerë që nuk banojnë në Shqipëri, aplikimet e të cilëve nuk janë pranuar”.

Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitutionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1 të tij ka përcaktuar misionin e arsimit të lartë, duke përkufizuar se:

“Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të

⁹ Në vijim referuar edhe si vetë FEUT, për sa kohë përfaqëson mendimin, opininin dhe vendimet e tij.

mësuarit gjatë të gjithë jetës; ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; d) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; dh) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë”.

Qëllimi i këtij Ligji është:

- a) të përcaktojë rolin e shtetit në arsimin e lartë;
- b) të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, rregullat e 18 krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit dhe mbylljes të institucioneve të arsimit të lartë;
- c) të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë;
- ç) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane;
- d) të vendosë arsimin e lartë mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;
- dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;
- e) të bazojë sistemin e arsimit të lartë mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve.

Ligji i njej dhe i jep liri akademike dhe autonomi institucioneve të arsimit të lartë, duke parashikuar¹⁰ se:

1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:

- a) për të organizuar veprimtaritë e mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

.....

4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës:

- a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;
- b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me këtë ligj;
- c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;

¹⁰ Neni 3, i Ligjit.

ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Neni 79 “Studimet e doktoratës”, ka përcaktuar, ndër të tjera, se:

“.....

2. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
4. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.
5. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.
6. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar dhe përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore “Doktor”.

Me vendimin nr. 08, datë 26.04.2021, të Senatit Akademik të UT-së, është miratuar Rregullorja “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”, e cila ka për qëllim të përcaktojë rregulla të përgjithshme mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë të Universitetit të Tiranës.

Në nenin 6, të Rregullores janë përcaktuar kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve, duke specifikuar se:

“6.1 Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo të jetë personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- b) të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve"; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
- c) të ketë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, sipas përcaktimeve të njësisë bazë;
- d) të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja të specifikuara...

- e) të ketë dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- f) të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

Përveç kritereve të parashikuara sa më sipër, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë edhe kritere të tjera shtesë, që mund të kene lidhje me aftësitë kërkimore-shkencore të aplikantëve.

6.2 Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet në njësinë bazë dhe përmban dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listen e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listen e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- dy rekomandime nga personel akademik me titull "Profesor i Asociuar" ose "Profesor";
- dëshmi të gjuhës së huaj, sipas pikës 6.1 (d); dh) dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
- deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- vendimi i njësisë bazë për fushat e kërkimit shkencor të njësisë;
- vendimi i njësisë bazë për pranimin e dokumentacionit për aplikim;
- propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
- vërtetim nga qendra e punës, që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- mandat pagese për tarifen e aplikimit;
- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

Në nenin 6.4, të Rregullores, përcaktohet se:

“Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përbërjen e të cilit janë të gjithë anëtarët e njësisë bazë, që mbajnë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Komisioni përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, të cilat bëhen transparente dhe publikohen në faqen e internetit të çdo njësie kryesore, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

Komisioni ad hoc, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve themelore, bën përzgjedhjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kriterëve specifike të aplikantëve. Lista e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad hoc, miratohet në mbledhjen e njësisë bazë.

Kandidati ka te drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë sekretarisë së njësisë kryesore.

Njësia bazë njofton me shkresë përcjellëse Dekanin për kandidatët fitues”.

Neni 7, i Rregullores parashikon se:

“7.1 Çdo njësi bazë duhet të përcaktojë kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit paraardhës kalendarik për të gjitha programet e studimit, që ofron. Kuotat i përcillen Senatit Akademik të UT-së për miratim.

7.2 Çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.

7.3 Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të IAL-së, si dhe në ambientet e tyre, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave”.

Bazuar në sa më lart, nga ana e FEUT-së, ka shkelje të procedurës për shqyrtimin kërkesës e dosjes së ankuesit, për regjistrim në programin e doktoratës, të cilat, Komisioneri i cilëson e vlerëson të atij niveli, që kanë cënuar rëndë të drejtën e tij për një vlerësim konform parashikimeve të përcaktuara në aktet rregullatore përkatëse, që do të analizohen më poshtë, dhe që e bëjnë të paligjshme vendimmarrjen e FEUT-së, lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës së ankuesit nga ana e Komisionit Ad-Hoc.

Për rrjedhojë, Komisioneri nuk do të bëjë analizën dhe vlerësimin nëse kriteri dhe arsyet e dhëna nga FEUT, për të cilin ankuesi është përjashtuar nga e drejta e tij për të vijuar me shqyrtimin e kërkesës së tij për regjistrim në programin e doktoratës, nga ana e Komisionit Ad-Hoc, është i drejtë, ligjor apo objektivisht i arsyeshëm e i justifikuar, për sa kohë që këtë konkluzion e vendimmarrje e ka bërë një person i vetëm, i cili nuk ka kompetencën e tagrin për ta bërë atë, pasi A. B i ka atribuar vetës cilësitë e kompetencat e Komisionit Ad-Hoc.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mungesa e një akti të mirëfilltë administrativ e vë ankuesin në pamundësi të kundërshtimit të tij në instancat përkatëse, duke i hequr “de facto” të drejtën e ankimit.

Komisioneri vlerëson se, shkeljet e rënda proceduriale të FEUT-së kundrejt ankuesit, kanë të bëjnë me:

Së pari, referuar parashtrimeve dhe qëndrimit të mbajtur nga ana e FEUT-së dhe UT-së, para Komisionerit, rezulton se nga ana e tyre është pranuar dhe është marrë i mirëqenë fakti i legjitimitetit të personit, punonjës A. B, si personi apo organi kompetent, i cili kishte tagrin për t'i kthyer përgjigjen ankuesit lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës dhe dosjes së tij, që kishte të bënte me regjistrimin në programin e studimeve të doktoratës, si dhe njëherësh përjashtimin/skualifikimin e tij në këtë procedurë.

Së dyti, referuar përcaktimeve sipër cituar, nga këqyrja e akteve të dosjes së subjektit ankues rezulton se është shkelur në mënyrë flagrante pika 6.4 dhe 6.5, e nenit 6¹¹, të Rregullores “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”, pasi kërkesa e aplikantit I. D, është refuzuar nga punonjësja A. B e FEUT-së, e cila, mban detyrën e Kryetares së Degës së Kualifikimit Shkencor, pranë FEUT-së dhe jo nga Komisioni Ad-Hoc, i ngritur pranë kësaj njësie, në përbërje të të cilit janë të gjithë anëtarët e njësisë bazë, me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, gjë që ka cenuar rëndë procedurën administrative në fjalë dhe për pasojë edhe vendimmarrjen lidhur me kërkesën e ankuesit.

Lidhur me sa më sipër, jo pa qëllim është përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, fakti që, një kërkesë e tillë (bashkë me dosjen e depozituar nga aplikanti) shqyrtohet nga ky Komision i posaçëm ad-hoc, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar shkeljet dhe natyrën e tyre; si dhe duke përcaktuar përbërjen e këtij Komisioni, metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, si dhe transparencën që shoqëron gjithë këtë procedurë.

Nga ana e FEUT-së, nuk janë vënë në dispozicion akte shkresore lidhur me dokumentimin e procedurës së ndjekur prej tyre për krijimin e Komisionit Ad-Hoc, metodologjinë e procedurën e ndjekur nga Komisioni për vlerësimin e kandidatëve. Nga ana e FEUT-së nuk u dokumentua se ku është e parashikuar e drejta e Kryetares së Degës së Kualifikimit Shkencor, dhe jo e Komisionit Ad-Hoc, për të refuzuar kandidaturat e paraqitura për programin e studimeve të doktoratës.

Legjislacioni në fjalë, është kujdesur veçanërisht që të detajojë një procedurë të tillë, pasi, në vijim të përmbushjes sa më sipër, Komisioni Ad-Hoc, pasi verifikimit të përmbushjes së kriterëve themelore, bën edhe përzgjedhjen e kandidatëve, duke u referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kriterëve specifike të aplikantëve, listë kjo e cila pasi është përzgjedhur nga Komisioni Ad-Hoc, miratohet në mbledhjen e njësisë bazë.

¹¹ Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve.

Sa në sipër, është përcaktuar qartë detyrimi që shqyrtimin e vlerësimin për përmbushjen apo jo të kriterëve të përcaktuara, e bën ky Komision Ad-Hoc, vendimmarrja e të cilit është kolegjiale, dhe jo një person i vetëm, i cili, në tejkallim të kompetencave dhe në keqzbatim e shkelje të dispozitave sa më sipër, të Rregullores “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”, ka marrë atributet e Komisionit Ad-Hoc për t’u shprehur dhe ka përjashtuar aplikantin/ankuesin nga e drejta e shqyrtimit të kërkesës së tij për regjistrimin në programin e studimeve të doktoratës, sipas procedurës të përcaktuar në këtë Rregullore.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, ankuesit, nga ana e FEUT-së, duhet t’i ishin siguruar të gjitha garancitë ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor rregullator në fuqi, në mënyrë që ai të kishte mundësi reale për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë lidhur me shqyrtimin e trajtimin e kërkesës së tij, por edhe për t’u mbrojtur efektivisht, në rastin kur nuk do të ishte dakord me këtë vendimmarrje¹².

Ankuesit nuk rezulton t’i jetë komunikuar një vendim i arsyetuar i organit kompetent, Komisionit Ad-Hoc, i cili kishte detyrimin ligjor për të dalë në një vendimmarrje të tillë, në mënyrë që ai të mund ta kundërshtonte atë, sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara.

Në konkluzion të sa mësipër, Komisioneri vlerëson se, e gjithë procedura e ndjekur nga ana e FEUT-së, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për regjistrimin në programin e doktoratës, është në kundërshtim flagrant me dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon metodologjinë dhe procedurën që duhet ndjekur për shqyrtimin e kërkesës e dosjes së aplikuesit për regjistrimin në programin e doktoratës. Kjo gjë që e bën vendimmarrjen për të, (pavarësisht se ajo është në formën e një komunikimi me e-mail) të paligjshme, si një veprim i cili vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat urdhëruese të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me kompetencën e organit publik për këtë vendimmarrje dhe procedurën e nxjerrjes së tij.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, ankuesi, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë e të paligjshëm, në shkelje të dispozitave sa më sipër cituar, në të drejtën e tij, që kërkesën e dosjen e paraqitur, për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës, duhet ta shqyrtonte e vlerësonte Komisioni i posaçëm Ad-Hoc, dhe jo një punonjëse e vetme e FEUT-së, dhe për më tepër pa asnjë kompetencë për të bërë një gjë të tillë.

A. Shkaku i mbrojtur.

¹² Pika 6.6, e nenit 6, të kësaj Rregulloreje ka parashikuar se: “Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues...”.

Mbështetur në nenin 2¹³, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B.1 Vendbanimi

Komisioneri vlerëson se “vendbanimi” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “vendbanimit”, Komisioneri gjykon se “vendbanimi” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Duke ju referuar vetë përgjigjes që FEUT (punonjësja A. B) drejtuar ankuesit, lidhur me argumentin se përse dosja e tij e aplikimit për programin e doktoratës pranë FEUT-së, nuk mund të konsiderohet, evidentohet se, arsyeja e dhënë ishte shprehimisht, se :“vendqëndrimi juaj është jashtë Shqipërisë (kontrata full time në American University of the Middle East)”. Për rrjedhojë është pranuar nga FEUT, që si shkak ligjor i refuzimit të shqyrtimit të kërkesës së tij, ishte vendqëndrimi i tij, jashtë Shqipërisë, që në kontekst të këtyre rrethanave mund të interpretohet edhe si vendbanim i përkohshëm i tij, varësisht nga rrethanat specifike të ankuesit.

Fakti i vendbanimit apo vendqëndrimit të përkohshëm të ankuesit është justifikuar e provuar nga ai, me faktin që është i punësuar si personel akademik pranë American University of the Middle East, në shtetin e Kuvajtit, që prej vitit 2017 e në vijim (momentin e aplikimit të ankuesit në programin e doktoratës, pranë FEUT-së ka depozituar dokumentin e lëshuar nga ky Universitet). Pra, në kontekst të sa më sipër shpjeguar, vendbanimi i përkohshëm i ankuesit, në periudhën e aplikimit të tij, pranuar nga të dyja palët, ishte shteti i Kuvajtit, ku ai ishte i punësuar dhe ushtronte detyrën, pranë American University of the Middle East.

¹³“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

Rrjedhimisht kjo gjë e lidh trajtimin që i bëhet ankuesit, me vendbanimin e tij për shkak të punësimit, bazuar në shpjegimin sipërcituar. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se “shkaku” për të cilin subjekti është trajtuar në mënyrë përjashtuese nga ana e FEUT-së, është pikërisht vendbanimi i tij, i cili në rastin konkret përkon me vendqëndrimin e tij të përkohshëm në Kuvajt, për shkak të punësimit jashtë Shqipërisë.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), është “*veçoria personale*” në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GJEDNJ, shkaku i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ, dhe nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara¹⁴.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm, të subjektit ankues, me shkakun e mbrojtur, nga ana e FEUT-së.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi mbart shkakun e pretenduar.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e FEUT-së, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të vendbanimit jashtë Shqipërisë për shkak të punësimit të tij, vetëm lidhur me respektimin e procedurës së përcaktuar përpara i takon shqyrtimit të kërkesës së tij për regjistrimin në programin e doktoratës, dhe jo me analizimin e vlerësimin e faktit nëse kjo vendimmarrje ishte e drejtë dhe e ligjshme.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt. Kjo në këndvështrimin referuar faktit nëse, FEUT, ka respektuar të drejtën igjore të ankuesit, lidhur me shqyrtimin e vlerësimin e kërkesës së tij, nga organi legjitim, i përcaktuar në aktet rregullatore përkatëse, dhe që kishte kompetencën për ta bërë një vlerësim të tillë.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e në shkelje të dispozitave sa më sipër cituar, në të drejtën e tij, që kërkesën e dosjen e paraqitur, për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës, duhet ta shqyrtonte e vlerësonte Komisioni i posaçëm Ad-Hoc, dhe jo një punonjëse e vetme e FEUT-së, dhe për më tepër pa asnjë kompetencë për të bërë një gjë të tillë.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

¹⁴ Handbook on European Non-discrimination Law. EU FRA and CoE, 2010.97

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për arsim në mënyrë të padirenuar.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁵.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁶

Katalogu i të drejtave të mbrojtura nga Konventa përfshin kryesisht të drejta civile dhe politike. Përfashtim është bërë për disa të drejta të karakterit socio-ekonomik që konsiderohen thelbësore për ekzistencën e njeriut, të cilat iu shtuan tekstit origjinal të Konventës me Protokollin nr. 1. Në këto të drejta përfshihet dhe e drejta për arsim.

Neni 2 i Protokollit nr. 1, të Konventës, përcakton se: “*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim*”. Konventa garanton veçanërisht mbrojtjen nga diskriminimi në arsim, si dhe krijon detyrime pozitive për shtetin. E drejta për arsim bën pjesë në kategorinë e të drejtave “të tjera” të mbrojtura nga Konventa, për kufizimin e të cilave shtetet palë duhet të krijojnë sisteme rregullatore për zbatimin efektiv dhe gëzojnë një hapësirë më të gjerë vlerësimi për kufizimin e tyre.

¹⁵Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011.

¹⁶https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

E drejta për arsim reflektohet edhe në nenin 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut¹⁷, në të cilin thuhet: *"Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi do të jetë falas, të paktën në fazat fillestare dhe themelore. Arsimi fillor do të jetë i detyrueshëm. Edukimi teknik dhe profesional do të vihen përgjithësisht në dispozicion dhe arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave... "*

Konventa e UNESCO/1960, kundër diskriminimit në arsim, mbron të gjithë qytetarët e shteteve palë nga diskriminimi në arsim për çdo lloj shkak. Gjithashtu, ajo i kërkon shteteve të ndërmarrin masa për të formuluar, zhvilluar dhe zbatuar politika kombëtare të cilat promovojnë trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969¹⁸) e cilëson të drejtën e arsimimit si të drejtë universale. Kjo natyrë i vishet kësaj të drejte, sipas parashikimeve të nenit 13 të Paktit, pasi ajo shtrin garancinë për çdo individ pavarësisht nga mosha, gjuha, origjina ose status tjetër. Neni 13, pika 2 parashikon që: *"2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte: ...c) Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme..."*

Karta Sociale Evropiane (1961) është një akt ndërkombëtar i miratuar nga KiE, e cila plotëson parashikimet e KEDNj-së, sa i takon të drejtave sociale dhe ekonomike. Kjo Kartë është rishikuar në 1996 dhe mbron të drejtat e konsideruara si gjenerata e dytë e të drejtave dhe nuk kanë gjetur vëmendje të njëjtë nga shtetet palë krahasuar me KEDNj. E drejta për arsimim garantohet nga disa nene të Kartës, konkretisht nenet 7 dhe 19, të ratifikuara dhe nga Shqipëria.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ka përfshirë të drejtën për arsim, si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *"a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin."*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

¹⁷ Në nenin 26 thuhet: *"Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave"*.

¹⁸ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore datë 16.12.1969, ratifikuar nga shteti Shqiptar më datë 4 Tetor 1991.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Kodi i Procedurës Administrative dhe ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palëstjetër/organit publik, në këtë Këshillit të Ministrave, i cili duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
 2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.
- Nëse “diskriminuesi i pretenduar” nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin¹⁹.

¹⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij:

“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në analizë përse më sipër, Komisioneri prezumon faktin se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pa drejtë e të pafavorshme, duke u mbështetur në faktin që, (sikurse vetë strukturat e FEUT-së i kanë pohuar ankuesit, por edhe para KMD-së), vendbanimi/vendqëndrimi i tij i përkohshëm jashtë Shqipërisë, për asrye të punësimit të tij në AUM/Kuvajt, ka shërbyer si shkak për mosshqyrtimin e kërkesës e dosjes së tij nga ana FEUT-së, lidhur me regjistrimin në programin e doktoratës, pranë këtij Fakulteti dhe përjashtimin e tij nga kjo e drejtë.

Sa më sipër, në rastin në shqyrtim duket qartë që ka një lidhje mes trajtimit të diferencuar dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Lidhur me këtë moment, *në parim*, Komisioneri, në raste të ngjashme²⁰ ka vlerësuar nëse një diferencë e tillë është justifikuar objektivisht, pra specifikisht, nëse ka ndjekur një qëllim legjitim, dhe nëse mjetet e përdorura kanë qenë në mënyrë të arsyeshme, proporcionale me qëllimin e ndjekur.

Mirëpo, *në rastin në fjalë*, Komisioneri vlerëson se lidhja e shkakut me trajtimin e padrejtë e të pafavorshëm të ankuesit nga ana e FEUT-së, nuk i nënshtrohet një analizimi e vlerësimi të tillë, pasi, Komisioneri nuk ka vlerësuar këtë vendimmarrje, nëse ajo është apo jo e drejtë dhe e bazuar në kriteret e vendosura; përse kohë që, FEUT kundërshtoi ankuesit ka konsumuar shkelje të atilla proceduriale, të cilat kanë cenuar rëndë këtë procedurë, duke e bërë atë të paligjshme e të padrejtë.

Në këtë kontekst, vetë FEUT, UT, në parashtrimet e tyre nuk kanë provuar se procedura e ndjekur prej tyre, është konform akteve rregullatore përkatëse, por janë investuar të argumentojnë se vendimmarrja e tyre ishte e drejtë dhe ligjshme. Fakt për të cilin Komisioneri nuk ka bërë asnjë analizë ligjore, përse kohë një vendim i tillë është marrë në mungesë të kompetencës së organit përgjegjës për të bërë një vlerësim e për të dalë me një vendimmarrje të tillë.

Në përmbyllje të gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se si do të ishte vendimmarrja lidhur me kërkesën e ankuesit për regjistrimin në programin e studimeve të

²⁰ Vendimi nr. 135, datë 22.07.2021, i KMD-së.

doktoratës, (gjë cila nuk është pjesë e analizës së këtij vendimi), FEUT, duhet të kishte respektuar të drejtën e ankuesit, bazuar në detyrimin ligjor të tyre, për kalimin e kërkesës e dosjes së tij, për shqyrtim, pranë Komisionit Ad-Hoc, të ngritur për këtë funksion, në respektim të nenit 6, të Rregullores “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”, dhe jo të lejonte (për më tepër të mos vepronte as në vijim për korrigjimin e saj) një shkelje kaq të rëndë të procedurës që duhej ndjekur për kalimin për shqyrtim të kërkesës e dosjes së tij, tek organi kompetent, Komisioni Ad-Hoc, i ngritur për të kryer këtë funksion.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shumë qartë se qëllimi i tij, është të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë (përfshirë të tria ciklet e tij)

Vetë ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon si qëllim të tij, të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane; por njëkohësisht po ky ligj parashikon si një nga qëllimet e tij edhe të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë, përfshirë të gjitha ciklet e programeve të studimit.

LMD, i ndryshuar, në nenin 17, të tij siguron mbrojtje nga diskriminimi në fushën e arsimit, duke përcaktuar se: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshë nga ana e FEUT-së, lidhur me mosrespektimin e shkeljen e së drejtës së tij, që kërkesën e dosjen e paraqitur, për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës, duhet ta shqyrtonte e vlerësonte Komisioni i posaçëm Ad-Hoc, dhe jo një punonjëse e FEUT-së, që nuk kishte asnjë kompetencë për të bërë një gjë të tillë.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson që, FEUT, ka shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e moskalimit për shqyrtim të kërkesës e dosjes së ankuesit pranë komisionit Ad-Hoc, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e marrë masat për kalimin e shqyrtimin e saj pranë këtij Komisioni.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji nuk do të ishte efektive nëse subjektet për të cilat është konstatuar se kanë shkelur dispozitat e LMD-së, nuk do të ndërmerrnin masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimit apo mosveprimit të tyre.

LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij, duke sanksionuar se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e shkeljeve të rënda procedurale nga ana e FEUT-së, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke marrë masat e menjëhershme, brenda një afati të arsyeshëm, për kalimin për vlerësim të dosjes së kërkesës së I. D, pranë Komisionit Ad-Hoc, pranë FEUT-së, të ngritur për këtë funksion, në zbatim të nenit 6, të Rregullores *“Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1,2,5, të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, nenin 17, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, I. D, për shkak të vendbanimit për arsye të punësimit jashtë Shqipërisë, në të drejtën e tij për arsim, nga ana e Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës (FEUT).

2. FEUT, të marrë masat përkatëse, brenda një afati të arsyeshëm kohor, për kalim e dosjes së kërkesës së I. D, për shqyrtimin e vlerësimit të saj, në Komisionin Ad-Hoc, pranë FEUT-së, të ngritur për këtë funksion.
3. FEUT, rekomandohet të marrë masat e nevojshme, për respektimin e të gjitha pikave të Rregullores “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës” dhe legjislacionit në fuqi, në kuadër të transparencës dhe së drejtës për informim, lidhur me metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, dhe publikimit të tyre në faqen e internetit të çdo njësie kryesore, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve²¹.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, FEUT, UT, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Arsim
Shkaku: Vendbanimi

²¹ Sipas përcaktimit të pikës 6, të kësaj Rregulloreje.